

Prof. Asoc. Dr. Mirdaim Axhami ka fituar titullin akademik Prof. Asoc. në Maj 2015 nga Universiteti i Tiranës dhe është i punësuar me kohë të plotë pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës që nga muaji Shtator 2003. Aktualisht është Përgjegjës i Departamentit Marketing Turizëm në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës si dhe Anëtar i Senatit Akademik të UT nga muaji Gusht 2020. Gjatë veprimtarisë së tij në FEUT ka shërbyer edhe si anëtar i Këshillit të FE, UT., në vitet 2012-2016 si dhe anëtar i Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës në Universitetin e Tiranës në vitet 2019-2020.

Ka një përvojë pune 17 vjeçare si pedagog, kërkues shkencor, studiues dhe ekspert biznesi. Ka kryer studimet universitare në Administrim Biznesi, profili Marketing në vitet 1999-2003 dhe më pas studimet pasuniversitare Master në Administrim Biznesi pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2009 ka fituar titullin akademik “Docent”, ndërsa në vitin 2011 ka fituar gradën shkencore “Doktor” në fushën e marketingut.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë Baza Marketingu, Drejtim Marketingu, Menaxhim Marrëdhëniesh me Klientët, Menaxhimi i Markës, Komunikimi Marketing. Ka shërbyer si konsulent biznesi në kompanitë më të mëdha në Shqipëri në riorganizimin e proceseve të biznesit si dhe ka trajnuar më shumë se 3000 punonjës në fushën e marketingut dhe shitjeve.

Ka marrë pjesë në disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të tilla si: *“Sustainable development of BLUE economies through higher education and innovation in Western Balkan Countries – BLUEWBC”* dhe *“INTERNationalization at Home: Embedding Approaches and Structures to Foster Internationalization at Western Balkans - INTERBA”*, financuar nga programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian.

Ka botuar artikuj në revista shkencore dhe refuar në konferenca të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare të botuara dhe organizuara nga universitete të njohura në vende të tilla si SHBA, Angli, Itali, Greqi, Lituani, Rumani, Maqedoni, Shqipëri, etj.,